



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 shkurt 2024
Nr. Ref.: RK 2348/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 215/23

Parashtrues

Gjylferije Mehana

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr.
227/2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 12 qershorit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gjylferije Mehana nga Vushtrria (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës). Parashtruesja e kërkesës përfaqësohet nga Ahmet Gjinovci, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 227/23] të 12 qershorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimin e kontestuar [Rev. nr. 227/23] të Gjykatës Supreme përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e ka pranuar më 12 korrik 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 tetor 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI215/23], caktoi gjyqtarin Radmomir Llaban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 13 tetor 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 13 tetor 2023, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 22 janar 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar në NKP "Higjiëna-Teknika" tani KRM Prishtina me seli pune në Prishtinë, prej 29 marsit 1986 në vendin e punës "Kontabiliste e mjeteve themelore".
12. Më 16 maj 2003, parashtruesja e kërkesës me kompaninë ka lidhur kontratë tjetër mbi punësim (kontrata nr. 806 me kohë të caktuar), në të cilën përcaktohej se parashtruesja e kërkesës është punësuar në pozitën "Manipulante - kontabiliste e librit amë", pozitë të cilën (sipas kontratës) do ta ushtronte deri më 30 qershor 2003. Pas kësaj date parashtrueses së kërkesës i është vazhduar marrëdhënia e punës me kontrata mujore.

13. Më 30 qershor 2003, parashtruesja e kërkesës dhe kompania kanë lidhur sërish kontratë mbi punësim (nr. 1348), përmes të cilës parashtrueses së kërkesës i është vazhduar kontrata e punës dhe është caktuar në të njëjtën pozitë (Manipulante - kontabiliste e librit amë), pozitë të cilën (sipas kontratës) do ta ushtronte deri më 31 dhjetor 2003.
14. Më 31 mars 2004, drejtori i NPK "Higjiena-Teknika" në Prishtinë nxori Vendimin nr. 397, në të cilin potencohet:
 - I. Të gjithë të punësuarve pranë NKP "Higjiena-Teknika" në Prishtinë, t'iu vazhdohet afati i kontratës së punës, për një (1) muaj, gjegjësisht deri më 30 prill 2004, përveç të punësuarës ... Gjylferije Mehana, manipulante – kontabiliste e librit amë, të cilës kontrata e punës nuk i vazhdohet.
 - II. Ky vendim të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në vendet për punëtorë.
15. Vendimi nuk përmbante asnjë arsyetim se pse parashtrueses së kërkesës nuk do t'i vazhdohej kontrata e punës e të punësuarve tjerë po. Mirëpo, nga vendimet gjyqësore që janë në dosjen e lëndës duket se arsye kryesore, pse parashtrueses nuk i ishte vazhduar kontrata e punës, është mungesa në punë për 11 (njëmbëdhjetë) ditë pune në periudha të ndryshme kohore.
16. Parashtruesja e kërkesës kundër vendimit numër. 397 të 31 marsit 2004, të punëdhënësit të saj në afatin ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ndërmarrjes, dhe lidhur me ankesën e parashtruar nuk kishte marrë përgjigjeje nga ndërmarrja.
17. Më 29 prill 2004, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkohej anulimi i vendimit nr. 397 të 31 marsit 2004 i punëdhënësit të saj me të cilin asaj nuk i vazhdohej kontrata e punës.
18. Më 22 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C1. nr. 129/04, ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës-paditëses Gjylferije Mehana, dhe ka ANULUAR si jo të ligjshëm Vendimin nr. 397 të 31 marsit 2004 për mos vazhdimin e kontratës së punës dhe ka detyruar të paditurën që ta kthejë paditësen në punë dhe në detyrat e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, sipas përgatitjes së saj profesionale që ka kryer deri më 31 mars 2004.
19. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Komunale në Prishtinë, në mes tjerash, arsyetoi: *"Me Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27, neni 9 janë paraparë kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja e themelimit të marrëdhënies së punës, e po ashtu janë paraparë edhe kur fillon marrëdhënia e punës dhe kur shkëputet kontrata e punës. Në nenin 11.4 është paraparë shkëputja e kontratës së punës me rastin e përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, ku në pikën (a) është paraparë për shkak të mungesës së paarsyeshme nga puna. Po ashtu, në nenin 11.6 është paraparë se punëdhënësi duhet ta paralajmëroj punonjësin 1 muaj para shkëputjes së kontratës. Kurse lidhur me 11 ditët e mungesës në punë të paditëses, dhe atë në periudha kohore të ndryshme, Gjykata vërtetoi faktin se e paditura së pari nuk ka aplikuar procedurat disiplinore ndaj paditëses për shkak të mungesës së paautorizuar nga puna, ku si dënime do të paraqiteshin eventalisht vërejtja me gojë, me shkrim, ndalesa e rritjes së rrogës, ulja e pozitës apo ndërprerja e punës. Por, me Vendimin e dt.31.03.2004, ka njoftuar paditësen për mos vazhdimin e kontratës së punës, dhe ia ka mohuar të drejtën e marrëdhënies së punës. Në anën tjetër, mungesat ditore nga puna kanë qenë gojarisht të lejuara nga shefja e*

kontabilitetit, po ashtu të arsyetuara edhe me dokumentacion mjekësor pos faktit që nuk kanë qenë të paguara 11 ditët e mungesës sipas listës së rrogave”.

20. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur NKP “Higjiena-teknika” në Prishtinë, ka parashtruar ankesë ndaj Aktgjykimit C1. nr. 129/04 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 22 majit 2007.
21. Më 24 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 429/2008, duke vendosur sipas ankesës të palës së paditur NKP “Higjiena-teknika” në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë, vendosi që të priset Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 129/04, i 22 majit 2007, dhe çështja t’i kthehet në rigjykim Gjykatës së shkallës së parë.
22. Gjykata e Qarkut lidhur me konstatimet e gjykatës së shkallës së parë rreth mungesës së parashtrueses nga puna në aktvendimin e vet, ndër të tjera, arsyetoi se, deklarata e KSH. si ish-udhëheqëse e drejtpërdrejtë e parashtrueses e dhënë në cilësinë e dëshmitares, në të cilën ajo pohoi se mungesat e parashtrueses nga puna ishin të arsyeshme sepse ajo që ia lejoi gojarisht ishin vlerësim i gabuar i gjykatës së shkallës së parë dhe nuk mund të merren si provë e besueshme, dhe *“Meqenëse, aktgjykimi ankimor është bazuar në fakte të cilat nuk janë vërtetuar drejtë ose plotësisht, e si pasojë e kësaj ka rezultuar edhe zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për këto shkaqe dhe arsye të paraqitura, kolegji aktgjykimin ankimor e prishi dhe çështjen ia kthen në rigjykim gjykatës së shkallës së parë”.*
23. Më 14 shtator 2011, në rigjykim, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 23/11, duke vendosur sipas vërejtjeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës - paditëses Gjylferije Mehana, dhe ka anuluar si të paligjshëm Vendimin nr. 397 të 31 marsit 2004 për mos vazhdimin e kontratës së punës. Gjykata Komunale ka detyruar të paditurën NPK “Higjieno-Teknika”, tani KRM “Pastrimi”, në Prishtinë, që paditësen ta kthej në punë dhe detyrat e punës në të cilën ka punuar më parë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, sipas përgatitjes së saj profesionale që ka kryer deri më 31 mars 2004.
24. Në Aktgjykim, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë në procedurë rigjykimi, duke iu referuar obligimeve të punëdhënësit sipas rregullores 2011/27 theksoi: *“Nga provat e administruara si dhe parashtrimet e palëve rezulton se e paditura në rastin e paditëses nuk e ka përfillur procedurën e paraparë me Rregulloren e cekur sepse ajo nuk e ka njoftuar paraprakisht paditësen për qëllimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, por drejtpërsëdrejti paditëses ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës”.*
25. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur NKP “Higjiena-teknika” në Prishtinë, ka parashtruar ankesë ndaj Aktgjykimit C. nr. 23/11 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 14 shtatorit 2011.
26. Më 12 mars 2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur me Aktvendimin Ac. nr. 3015/2012 vendosi si në vijim: *“PRANOHET ankesa e të paditurës, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 23/2011 të datës 14. 09. 2011, dhe lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë si gjykatë e shkallës së parë në rigjykim”.*
27. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj lidhur me qëndrimin e shprehur në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, se punëdhënësi nuk e kishte njoftuar paraprakisht punonjësen për mos vazhdimin e kontratës së punës e që kishte obligim sipas Rreg. 2001/27, si dhe arsyetimin e mungesave nga puna, theksoi: *“Gjykata e Apelit e Kosovës*

në Prishtinë, një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë nuk mund të pranoj si të drejtë, për faktin se nuk ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht faktet të cilat ishin me rëndësi për të vërtetuar përgjegjësinë e paditëses, e kjo e kërkuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pra të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e sipas aktvendimit Ac. nr. 429/2008 të datës 24.12.2010 dhe atë në drejtim të vërtetimit se paditësja a e ka paralajmëruar të paditurën për mungesat nga puna në periudhën kontestuese dhe faktin se shefja e kontabilitetit KSH. a ka pasur autorizime që paditëses t'ia arsyetojë mungesat nga puna”.

28. Më 3 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së parë, duke vendosur për herë të tretë në procedurën e rigjyimit nxori Aktgjykimin C. nr. 1657/14, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe e ka anuluar si të kundërligjshëm vendimin nr. 397, të 31 marsit 2004, të ndërmarrjes ku ishte punësuar parashtruesja e kërkesës e me të cilin asaj nuk i vazhdohej kontrata e punës, duke e detyruar të paditurën që ta kthejë në vendin e punës paditësen-parashtruesen e kërkesës, njëkohësisht, duke e detyruar ndërmarrjen e paditur që paditëses t'ia kompensojë të ardhurat e humbura personale dhe detyrime tjera financiare të cekura si në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
29. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur NKP “Higjiena-teknika” në Prishtinë, ka parashtruar ankesë ndaj Aktgjykimit C. nr. 1657/14 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 3 korrikut 2015.
30. Më 7 qershor 2018, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, nxori Aktvendimin Ac. nr. 4076/2015, me të cilin vendosi: *“PRANOHET ankesa e të paditurës, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1657/2014 i datës 03.02.2015 dhe çështja kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”.*
31. Në aktvendimin me të cilin prishi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kolegji i Gjykatës së Apelit, ndër të tjera arsyetoi: *“Kolegji vlerëson se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk jepen arsytet mbi faktet vendimtare. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se në çka e ka bazuar vendimin e vet. Neni 160.4 i LPK-së, udhëzon që arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”.*
32. Më 2 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm për herën e IV-të, në procedurë rigjykimi, me Aktgjykimin C. nr. 1921/18 vendosi, që të APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Gjylferije Mehana, nga Vushtrria, dhe të ANULOHET si i kundërligjshëm Vendimi me nr. 397 i 31 marsit 2004, i NPK “Higjiena-Teknika”, tani KRM “Pastrimi”, me seli në Prishtinë, për mosvazhdimin e kontratës së punës së paditëses, Gjykata Themelore gjithashtu theksoi në aktgjykim se VËRTETOHET, se paditësja Gjylferije Mehana e ka statusin e punëtores në kohë të pacaktuar dhe njëkohësisht obligoi të paditurën që paditësen ta kthejë në punë dhe detyra të punës që i ka kryer para se të mos i vazhdohej kontrata.
33. Në një datë të paspecifikuar, NKP “Higjiena-Teknika”, tani KRM “Pastrimi” me seli pune në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.
34. Më 7 prill 2023, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin CA-nr. 2784/2020, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur NKP “Higjiena-Teknika”, tani KRM “Pastrimi” në Prishtinë, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë, **e refuzon** ankesën e të

paditurës, ndërsa e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 1921/2018, të 2 dhjetorit 2019.

35. Kolegji i Gjykatës së Apelit në aktgjykimin refuzues kishte theksuar: *“Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, në pjesën vërtetuese të aktgjykimit të shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182, paragrafët b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë, në procedurë sipas ankesës kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje të treguara në ankesë e të cilat do të ishin me ndikim 'në vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në këtë çështje kontestimore dhe shtoi më tej se “Arsyetimi i aktgjykimit ankimor, përmban elementet e parapara me nenin 160, par. 4 e 5 të LPK-së, ai përmban arsye të plota dhe të qarta për të gjitha faktet vendimtare si dhe dispozitat e së drejtës materiale në të cilat gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin ankimor”.*
36. Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë C. nr. 1921/18, i 2 dhjetorit 2019 është bërë i plotfuqishëm më 7 prill 2023, ndërsa i ekzekutueshëm më 11 maj 2023.
37. Më 29 maj 2023, NPK “Higjiena-Teknika”, tani KRM “Pastrimi” SHA. me seli pune në Prishtinë, ka paraqitur kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit CA-nr. 2784/2020, të 7 prillit 2023.
38. Revizioni ishte paraqitur nga ndërmarrja e paditur duke u thirrur në nenin 32 [E Drejta për Mjete juridike], dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenin 211, paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ndërsa në kërkesën për revizion theksohej se veprimet e ndërmarrjes në raport me ish-punëtoren e tyre – këtu parashtruesen e kërkesës, bazoheshin në rregulloren 2001/27 të UNMIK-ut e zbatueshme në kohën referuese gjegjësisht në nenin 11.1 të saj, ku shprehimisht sipas pretendimeve të paraqitura në revizion përcaktohej:
- 11.1. "Kontrata e punës shkëputet:
(d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe ...*
- duke arsyetuar tutje se *“Në këtë kuptim, meqenëse kontrata e punës (me kohë të caktuar) e themeluar ndërmjet paditëses dhe të paditurës kishte skaduar, vendimi për mos vazhdimin e kontratës së punës duke u bazuar në mungesat e paarsyeshme të paditëses në vendin e punës, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm”.*
39. Më 7 qershor 2023, parashtruesja e kërkesës përmes përfaqësuesit të saj, avokatit Ahmet Gjinovci, ka dorëzuar në Gjykatën Supreme përgjigje ndaj revizionit të parashtruar nga pala e paditur. Në përgjigje përfaqësuesi i parashtrueses theksoi: *“Konsideroj se revizioni i të paditurës është tërësisht i pabazuar sepse pala e paditur nuk ofron asnjë provë apo fakt me të cilët do të provohen pretendimet e paraqitura në revizion”.*
40. Më 12 qershor 2023, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës për revizion të paraqitur nga pala e paditur (NPK “Higjiena-Teknika”, tani KRM “Pastrimi” SH.A.) dhe duke marrë për bazë edhe përgjigjen e dorëzuar nga pala paditëse (përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës) nxori Aktgjykimin Rev. nr. 227/2023, me të cilin vendosi që: PRANOHET si i themeltë revizioni i të paditurës dhe NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 2784/2020 i 7 prillit 2023 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 1921/18 i 2 dhjetorit 2019, ashtu që REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses Gjylferije Mehana nga Vushtrria, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës nr. 397 i 31 marsit 2004, i marrë nga

drejtori menaxhues i të paditurës, për mos vazhdimin e kontratës së punës nr. 1348 të 30 qershorit 2003, të detyrohet e paditura, që paditësen ta kthejë në punë dhe detyrat e punës të cilat i ka punuar më parë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës,

41. Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të saj për revizionin, Gjykata Supreme kishte theksuar: *“Në këtë gjendje të çështjes konkrete-juridiko - civile, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta gjyqësore, drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike, mirëpo, në bazë të gjendjes së tillë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë miratuar si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, për të cilën arsye është dashur që të pranohet revizioni i të paditurës si i themeltë dhe të ndryshohen aktgjykimet e të dy gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar”.*

Dhe, më tutje

“Kështu, për arsyet se sikundër rezulton nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara, vendimi i të paditurës për mos vazhdimin e kontratës së marrë, veç tjerash, në përputhje me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, që në atë periudhë ishte në fuqi dhe i zbatueshëm. Me dispozitën e nenit 10.1 të Rregullores së sipërpërmendur, përcaktohet se "Kontrata e punës mund të lidhet: a) për një kohë të pacaktuar ose b) për një kohë të caktuar". Me par.2 të nenit 10, parashihet se ajo lidhet në formë të shkruar..., dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe punonjësi dhe përfshin edhe çështje të tjera, si vendin e punës, emrin, natyrën, llojin e punës, orët e punës, datën e fillimit të punës, kohëzgjatjen e kontratës së punës, lartësinë e pagës etj. Me dispozitën e nenit 11.1 (pika d) të kësaj Rregulloreje, parashihet veç tjerash, se kontrata e punës shkëputet edhe me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit. Ndërkohë që, kështu është rasti konkret me punëtoresh, këtu paditësen, e cila, sikundër u theksua më lart edhe në kontratën e sipërcekur të punës, të lidhur me pëlqimin dhe vullnetin e tyre të ndërsjellë të paditura me kohë të caktuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve].

i. pretendimet për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës

43. Parashtruesja e kërkesës nuk e ka përcaktuar qartë se si i është shkelur e drejta kushtetuese për barazi para ligjit, por në kërkesë ajo pretendon se *“Kur kemi parasysh rrethanat e cekura më sipër, kohën e tejzgjatur të këtij kontesti të punës nga viti 2004, mbi 19 vite, vendosja me revizion në afat për 4 ditësh nga dita e dhënies së përgjigjes në revizion, në të njëjtën ditë, sipas informacionit që kam siguruar, lënda është dërguar në Gjykatën Supreme, kur dihet se në Gjykatën Supreme ka lëndë që presin me muaj, mendojmë se Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje kontestimore ka krijuar një standard i cili deri më tani nuk ka ekzistuar në praktikën gjyqësore.*

44. Nga si më sipër duket se parashtruesja e kërkesës pretendon se rasti i saj nuk është trajtuar si rastet tjera në Gjykatën Supreme sepse është vendosur shumë shpejt, duke marrë parasysh *“se ka lëndë që presin me muaj”* në atë gjykatë dhe gjithashtu duke marrë kohëzgjatjen e procedurave në shkallë tjera gjyqësore.

i. Pretendimet për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës

45. As edhe pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës nuk e ka precizuar qartë se si dhe për cilat arsye është shkelur në dëm të saj, porse duke vlerësuar aktgjykimin e revizionit ka theksuar: *“Konsiderojmë, se edhe këtu gjykata Supreme ka shkelur të drejtat themelore në dëm të palës paditëse të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës sepse është e palogjikshme dhe deri tani nuk ka ndodhur që gjykata t’ia mohoj të drejtën punëtorit në kompensimin e të ardhurave personale, kur të dy gjykatat e instancave më të ulëta, mbi bazën e provave dhe fakteve, kanë vërtetuar se paditësja e ka statusin e punëtores në kohë të pacaktuar.*

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve]

- 1. E drejta e punës garantohej.*
- 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës

Neni 10

Kontrata e punës

10.1 Kontrata e punës mund të lidhet:

- (a) për një kohë të pacaktuar ose*
- (b) për një kohë të caktuar.*

[...]

Neni 11

Shkëputja e kontratës së punës

11.1 Kontrata e punës shkëputet:

[...]

*(d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe
(dh) sipas fuqisë ligjore.*

[...]

Neni27

Ligji në fuqi

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 211

211.1 Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.

Neni 212

Për revizionin vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

Neni 213

Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjyqimit të formës së prerë të goditur.

Neni 224

224.1 Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

48. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

49. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 34 (2) parasheh:

Gjykata mund ta konsideroj kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.

50. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës: i. është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ajo konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Rev. nr. 227/2023, të Gjykatës Supreme, të 12 qershorit 2023; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç përcakton neni 49 i Ligjit.

51. Andaj, në raport me si më sipër, në vijim, Gjykata do të trajtojë meritat e rastit për të përcaktuar nëse kërkesa dhe pretendimet e ngritura janë brenda ose jo kuadrit të përcaktuar me kriteret e rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.
52. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "qartazi e pabazuar" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë në vete.
53. Në këtë drejtim, pretendimet e tilla, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë" të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara"; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta".
54. Në këtë kontekst, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
55. Në dritën e kësaj kornize normative, Gjykata sjellë në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me pretendimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me mos vazhdimin e kontratës së saj të punësimit tek punëdhënësi i saj ku kishte punuar 19 (nëntëmbëdhjetë) vite.
56. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se në thelb me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme Rev. nr. 227/2023 të 12 qershorit 2023, specifikisht i janë shkelur dy të drejta kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit], dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës. Prandaj, Gjykata do t'i shqyrtojë këto pretendime veçmas.

i) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës

57. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të barazisë para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, parashtruesja – përfaqësuesi i saj nuk ka specifikuar se si është shkelur kjo e drejtë në rastin e saj, por vetëm ka theksuar se, "*Gjykata Supreme në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.06.2023, /dite e hënë/që i bie pas 4 ditë pune, (pasi është dorëzuar përgjigjja në revizion) ka marr aktgjykimin për të cilin pretendojmë se është marr me shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë*". ...Dhe, më tutje "*sikur në Gjykatën Supreme, të mos kishte tjera lëndë fare që presin në radhë për t'u zgjidhur, pra, sikur dikush me ndikim dhe interes qëndron mbrapa kësaj lënde dhe ka qenë i interesuar që çështja të vendoset ashtu siç është vendosur, në dëm të palës paditëse*".
58. Gjykata, në këtë kontekst thekson se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) dhe (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj

gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih, rastet e Gjykatës [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, paragrafi 85, dhe [KI124/20](#) parashtrues *Muhamet Ali Ceysülmedine*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 42) dhe [KI 221/21](#), parashtrues *Shpejtim Gacaferri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 marsit 2022, par. 55.

59. Parashtruesja e kërkesës në kërkesë nuk ka shtjelluar se pse i është shkelur kjo e drejtë kushtetuese, se pse nuk u trajtua barabartë para ligjit ose ku qëndron pabarazia e saj në raport me raste të tjera si ky apo të ngjashme. Vetëm konstatimi se Gjykata Supreme vendosi shpejt në rastin e saj "*e që thuajse nuk kishte raste të tjera që presin për vendosje*" nuk përbën pretendim të bazuar që e shpie Gjykatën Kushtetuese për të gjetur shkelje të nenit 24 të Kushtetutës.
60. Gjykatës Kushtetuese, përveç konstatimit si më sipër, nuk iu ofrua asnjë provë tjetër që Gjykata Supreme ka qenë e ndikuar në vendimmarrje në Aktgjykimin e kontestuar sikur pretendoi parashtruesja e kërkesës, andaj Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, janë pretendime "të pambështetura apo paarsyetuara", dhe rrjedhimisht, pretendime të papranueshme, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit dhe rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.

ii) përkitazi me pretendimin e parashtrueses për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës

61. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se në kuptimin e kësaj të drejte konkrete, neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës, përkufizon një standard që përcakton garancitë dhe të drejtat për të punuar, mundësitë e punësimit dhe të sigurimit të kushteve të barabarta të punës pa diskriminim, si dhe të drejtën e zgjedhjes së vendit të punës dhe ushtrimit të profesionit në mënyrë të lirë, pa detyrime me forcë. (shih, ndër të tjera, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI46/15, me parashtrues *Zejna Qosaj*, publikuar më 20 tetor 2015, paragrafi 26 dhe shih gjithashtu Aktvendimin për pranueshmëri në rastin [KI64/18](#), parashtrues *Hasan Maxhuni* par. 74).
62. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtës në punë duhet kuptuar në dritën e interpretimit të mësipërm. Mbrojtja e të drejtave të punës, në mënyrë specifike, duke përfshirë edhe mënyrën e themelimit e edhe të ndërprerjes së saj, është e rregulluar me dispozitat e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës ose të ligjeve e rregulloreve të UNMIK-ut që kanë qenë në fuqi në kohën referuese kur ka filluar kontesti.
63. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesen e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të arsyetonte konkludimin se janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. (Shih, *mutatis mutandis* Gjykata Kushtetuese, në rastin KI136/14, parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 34, si dhe rastin KI42/17, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 53).
64. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se parashtrueses të kërkesës i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar, për t'i prezantuar faktet në dobi të saj dhe për t'i

kundërshtuar provat e palës kundërshtare. Në këtë kontest pune ka 4 vendime gjyqësore në shkallë të parë vendimmarrëse, 4 vendime gjyqësore në shkallë të dytë vendimmarrëse dhe një aktgjykim të Gjykatës Supreme dhe gjatë gjithë procedurës parashtruesja e kërkesës ishte pjesë aktive dhe e barabartë e procesit.

65. Për më tepër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme vendosi lidhur me kërkesën për revizion, duke u bazuar në kompetencën e saj të paraparë me nenet 212 dhe 224.1 të Ligjit nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore, kur konstatoi se e drejta materiale ishte zbatuar gabimisht, andaj edhe ndryshoi vendimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së dytë. Ajo konstatoi në Aktgjykim se Ligji i zbatueshëm në kontestin e ngritur nga parashtruesja e kërkesës ishte Rreg. e UNMIK-ut 2001/27 dhe se ajo rregullore parashihte se kontrata e lidhur për kohë të caktuar mund të mos vazhdohej sikurse në rastin konkret. Gjykata gjithashtu thekson se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 06/1.-054, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më 7 nëntor 2022, ka miratuar **qëndrim parimor** lidhur me kontestet e punës në të cilat zbatohet kjo rregullore dhe “*nuk zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës të Jugosllavisë i vitit 1977 me amendamentet përkatëse, dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e punës të KSA të Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 24/22 qershor 1984), dhe Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet e punës (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës nr. 14/1987 datë 24 prill 1987) e as dispozitat e Ligjit të mëvonshëm për marrëdhëniet e punës i KSA të Kosovës –gazeta Zyrtare nr. 12/1989 datë 14 prill 1989*”.
66. Gjykata më tej thekson se, mbi bazën e nenit të cekur më lart (neni 26, paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, Ligji nr. 06/1.-054), Gjykata Supreme “*përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës*”.
67. Gjykata konstaton se ky qëndrim parimor që vë obligim “*për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës,*” ishte nxjerrë nga Gjykata Supreme para se të nxirrej Aktgjykimi për revizionin në rastin e parashtrueses së kërkesës, andaj edhe Aktgjykimi Rev. nr. 227/2023 ishte në linjë me qëndrimet e shprehura në të.
68. Gjykata, në raport me rezultatin final të vendimmarrjes në këtë kontest, ripërsëritë praktikën e saj të konsoliduar se ajo nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta.
69. Në këtë drejtim, Gjykata kujton se në rastin *[Tomić e të tjerët kundër Malit të Zi](#)* (Aktgjykim i GJEDNj-së i 17 prillit 2012, par. 53), GJEDNj theksoi se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese “*të vë në pyetje interpretimin e ligjit nga gjykatat e rregullta sikurse që, në parim nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave kombëtare, edhe nëse janë dhënë në procese në dukje të ngjashme; ajo duhet të respektojë pavarësinë e këtyre gjykatave (shih, Nejdëti Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë [DH.M], nr. 13279/05, §§ 49-50, 20 tetor 2011*”.
70. Për më tepër, është roli i Gjykatës Kushtetuese që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”. (Shih, Aktgjykimin e GJEDNj-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 53; dhe *mutatis mutandis* në rastin [KI86/11](#), parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
71. Gjykata Kushtetuese ndërhyr vetëm atëherë kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e rregullta cenojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese. Në këto raste, Gjykata nuk bën

rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, apo ri-interpretim të ligjeve, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të rregullt.

72. Bazuar në si më sipër, Gjykata konkludon se parashtruesja e kërkesës nuk arriti të mbështes pretendimet e saj dhe të vërtetoj në baza kushtetuese se Gjykata Supreme i mohoi të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit.

Përfundim

73. Gjykata, pas shqyrtimit të fakteve të paraqitura në kërkesë, pretendimeve të ngritura të parashtrueses së kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 24 dhe 49 të Kushtetutës, në harmoni me praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNj-së konstaton se, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34, paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 22 janar 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani